

SHTOJCË NR. 3, DATË 07.02.2020

“Për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër më një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër 4 (katër) vite, me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Qendrën Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan”, me fond të marrëveshjes kuadër në verën prej 81,401,951 (tetëdhjetë e një milion e katërqind e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH dhe REF-46137-12-13-2019.

Në zbatim të nenit 42 dhe nenit 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; të nenit 62 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ; të nenit 5 dhe nenit 28, pika 1, gërma “b” të Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike” (publikuar në Fletore Zyrtare nr.10, viti 2020), me qëllim parandalimin e përfitimit të fondeve në procedurat e prokurimit publik që zhvillon Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, nga subjektet e parashikuara në këtë akt normativ, si dhe në mënyrë që verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, të kryhen në mënyrë të saktë, të plotë e të gjithanshme, bëhen ndryshimet si vijon në dokumentat e tenderit:

I. Në Shtojcën nr.7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, në paragrafin e tretë,

ISHTE:

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

(emër, atësi, mbiemër)

etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

BËHET:

- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

	Emër (Emrat)	Mbiemër	Datëlindje ditë muaj vit	Atësi	Amësi	Vendlindje
1						
2						
3						

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

II. Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, shtyhet për në datën 17.02.2020 ora 11:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.